



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:225144
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05855142

C-IV-13-0557

A S, Prizren.

Ankuesi:

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Ganimete Puka, me 24.qershor. 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRZ017-0144, dt.05.mars.2013.
2. **OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit A S në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t’i paguaj shumën prej 1.140.00 €(njëmijë i njëqind e katër dhjet euro) , dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 114€(njëqind e katërmëdhjetë euro), pjesa tjetër refuzohet si e pa bazuar.
3. **Shumat** e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në n e likuidimit.
4. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 15.prill.2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit nr. PRZ017-0144, dt.05.mars.2013. të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin AL, e refuzoj kërkesën ankuesit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 380.00 €, me arsyetim se ankuesi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH “ Ramiz Sadiku në Prizren” (në likuidim), në momentin e likuidimit të saj dhe as në listës e pagave të punëtorëve. Ankuesi pohon se sipas nenin 40.1.6.2. të shtojcës së Ligjit të AKP, i njihet e drejta në dëmshpërblim, për 5 paga në shumën prej 380€, ndërsa me parashtrësën e datës 08.maj.2024, i propozon gjykatës që ti njihet e drejta në kompensime në shumën prej 1520.00€, për 33 vite e 11 muaj e 24 ditë, shkak të largimi nga puna kundër vullnetit të tij.

Ankesës/parashtresës i ka bashkangjitur:

- Kopjen e Vendimit të AL dhe
- Kopjen e librezës së punës,
- Njoftimin e dt 21.shkurt.2006 e AKP/së nr. 380,

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 216.dhjetor.2014 parashtroj mbrojtjeje.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP pohoi se AL, me rastin e vendosjes, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Tutje, pohon se, ankesa është e pa bazuar dhe nuk gjen mbështet ligjor sipas dispozitë nenin 40.1.6.2. të shtojcës së Ligjit për AKP, pasi që ankuesi nuk ka ofruar shërbime në NSH nga vitin 2002- 2006, nuk është në listën e pagave të punëtorëve dhe ankuesit nuk i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshëm të marrëdhënies së punës. E paditura gjithashtu ka pohuar së, ankesa e ankuesi, është pa pranueshme, edhe pse AL, nuk e ka refuzuar ankesën si të pa pranueshme, ankuesi ankuesen e ka dorëzuar në AKP, me vonës pas 4 viteve, të dorëzimit të kërkesave, për çka e bën kërkesën të pa pranueshme, dhe në praktiken gjyqësore të DHPGJS, në një rast ekuivalent aktgjykimin i Kolegjit të Apelit C-IV-13-2578, C-IV-13-2620, C-IV-1754 et, dt.23.10.2014, ku duhet të merr për bazë me rastin e vendosjes. AKP nga të gjitha arsyet propozoj që ankesa të refuzohet si e papranueshme apo e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL me nr. PRZ017-0144, dt.05.mars.2013., me të cilën kërkohet dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në NSH “Ramiz Sadiku në Prizren,” (në likuidim) në shumë prej 1520.00€ €.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH, “Ramiz Sadiku”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor i NSH-së, nga vitin 01.06.1978, deri sa është njoftuar së ndërmarrja ka shkuar në privatizim dt. 21.02.2006.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin e datë 21.shkurt. 2006 për hyrjen e NSH-së në likuidim, librezën e punës nr. 1935, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, si dhe në parashtrësën e datës 08.maj.2024, i cili pohon së për shkak të ndërprerjes së parakohshme, të detyrohet e paditura t’ia kompensoj në emër të katër (4), pagat të papaguar, në shumën prej 1520.00€ . Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me në vitin 1978 deri në vitin 2006, më privatizimin e ndërmarrjes në fjalë).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës, njoftimin e datës 21 shkurt. 2006 si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, që gjykatës i shërbejnë si provë për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të kërkesës së ankuesit në lartësi prej 1.140.00 € në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 76.7.7.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën të cilën e ka llogaritur vetë ankuesi në kërkesën e tij në procedurë të likuidimit tek AL si dhe me rastin e parashtrimin të ankesës së tij në gjykatë, e që lartësia e kompensimit së kërkuar nga AL nuk është kontestuar, e as nga këtu e paditura AKP.

Gjykata me rastin e vendosjes nuk u lëshuar në pretendimin e të paditurës, se kërkesa e dorëzuar nga ankuesit në AL, është e pasafatshme, për faktin se AL, kërkesën e ankuesi nuk e ka refuzuar nga papranueshmëri e kërkesës dhe është lëshuar në meritë, andaj gjykata në këtë fazë është duke e shqyrtuar ankesën e ankuesit të dorëzuar në gjykatë si brenda afati ligjor, dhe gjykata nuk ka pas mundësi të lëshohet në vlerësimin pranushmerisë apo papranueshmërisë së ankesës, kur vetë

AL, nuk është lëshuar në një vlerësim të tillë , për çka edhe u vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata nxjerr përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Gjykata e aplikon interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore, mirëpo në rastin konkret pasi që pala nuk e ka kërkuar, gjykata nuk ka vendosur për interesin ligjor.

Andaj në bazë të te lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, taksa gjyqësore, në shumën prej 20 €, është paguar.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrahet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e